



## **Antarësimi në BE si rrezik për demokracinë shqiptare?!**

### **Blendi Kajsiu**

Ekziston një konsensus i gjerë se zvarritja e procesit të antarësimit të Shqipërisë në BE përbën kërcënim për stabilitetin e vendit dhe të rajonit. Dy janë argumentat mbi të cilat ngrihet ky konsensus. Së pari, zvarritja dhe inkoherenca në procesin e antarësimit e ka delegjtimuar BE-në duke dobësuar rolin e saj si promotor reformash dhe garant i demokracisë në vendin tonë. Së dyti, mungesa e një perspektive të qartë evropiane mund të prodhojë afrimin e Shqipërisë me aktorë të tjerë jo demokratik të rajonit si Turqia e Erdoganit.

Përballë kërcënimit që zvarritja e procesit të integritit paraqet për demokracinë shqiptare zgjidhja që ofrohet është pothuajse unanime: antarësim sa më të shpejtë të Shqipërisë në BE. Problemi është se në stadin ku ndodhet demokracia jonë anëtarësimi në BE është akoma më i rrezikshëm se stanjacioni i procesit të integritit. Pra kura, antarësimi në BE, është më e rrezikshme se vetë sëmundja, zvarritja e procesit të anëtarësimit.

Nëse Shqipëria bëhet anëtare e BE-së me të drejta të plota roli i kësaj të fundit si promotore dhe garante e demokracisë shqiptare zbehet shumë më tepër se sot. Pavarësisht zvarritjeve të procesit të integritit BE mbetet një aktor i fuqishëm në skenën tonë politike. Reforma në drejtësi dhe ndikimi i BE-së në të është dëshmi e qartë se ajo vazhdon të jetë garantuese dhe promovuese e demokracisë në vend.

Ama kur Shqipëria të bëhet anëtare e BE-së instrumenti i demokratizimit nëpërmjet kushtëzimit zbehet ndjeshëm për të mos thënë që zhduket. Nuk është rastësi që shumë nga vendet e rajonit si Rumania dhe Bullgaria, por edhe vende të Evropës Qendrore si Hungaria apo Polonia, kanë shënuar regres në nivelet e demokracisë pas antarësimit në BE. Për sa kohë demokratizimi nuk është qëllim në vetvete por një instrument për t'u futur në BE nuk është cudi që arritja e këtij objekti të shënojë fundin e procesit demokratizues.

Shembuj si ai i Hungarisë tregojnë qartë se antarësimi në BE nuk shënon domosdoshmërisht konsolidimin e demokracisë dhe aq më pak konsolidimin e orientimit perëndimor të një vendi. Hungaria sot jo vetëm është më pak demokratike se dje kur ishte jashtë BE-së, por është edhe më afër aktorëve jo-demokratik dhe anti-perëndimorë si Rusia e Putinit, Turqia e Erdoganit dhe Kina e Xi Ping. Është një orientim që shpesh bie ndesh me politikën e jashtme të BE-së.

Ndaj edhe antarësimi i Shqipërisë në BE nuk do të evitojë domosdoshmërisht afrimin e saj me aktorë problematikë si Turqia e Erdoganit. Përkundrazi, ai nënkupton më shumë sovranitet dhe më pak kushtëzim të Shqipërisë në politikën e saj të jashtme. Dhe nëse kemi

parasysh afrimetet kulturore, politike, ekonomike dhe gjeostrategjike mes dy vendeve nuk është aspak cudi që lidhja me Turqinë të trashet edhe nëse kjo e fundit transformohet në diktaturë.

Megjithatë as Turqia, as Kina, dhe aq më pak Rusia, nuk do mund të zëvendësojnë BE-në, edhe nëse Shqipëria mbetet pafundësisht në paradhomën e anëtarësimit evropian. Së pari, sepse Shqipëria është thellësisht e integruar ekonomikisht me BE-në, që është partnerja kryesore ekonomike e vendit tonë, pa përmendur emigracionin masiv shqiptar që derdhet kryesisht në vendet e BE-së. E thënë ndryshe si për arsye ekonomike, gjeostrategjike apo kulturore as Turqia, as Kina, dhe aq më pak Rusia, nuk mund ta zëvendësojnë Evropën në rastin e Shqipërisë. Së dyti, as Rusia dhe as Kina nuk mund ta zëvendësojnë Evropën si burim legjitimimi për klasën tonë politike. Shoqëria shqiptare në shumicën e saj e sheh, dhe dëshiron ta shohë, vehten si evropiane dhe nuk ka dilema mes Lindjes dhe Perëndimit, sic ndodh në rastin e Serbisë.

Kjo do të thotë se rreziku që Shqipëria të humbasë orientimin e saj perëndimor apo të bjerë pre e influencave lindore si pasojë e zvarritjes së procesit të integritit është tejet i ekzagjerur. Është një kërcënim që përdoret dhe fryhet rëndom nga qeveria për të hapur dyert e BE-së. Por e vërteta është se Shqipëria nuk ka ku të shkojë. Maksimumi do krijojë partneritete të reja si Ballkani i Hapur me Serbinë, por pavarësisht kritikave ndaj kësaj iniciative askush nuk mendon se ajo është një alternativë reale ndaj BE-së.

Për të gjitha këto arsye rreziku që i vjen demokracisë shqiptare nga zvarritja e procesit të integritit ka mjegulluar një problem akoma më të madh, atë të anëtarësimit në BE. Kjo nuk do të thotë që zvarritja e integritit nuk përbën një problem real për demokratizimin tonë. Në fund të fundit ai mbetet një proces që bazohet tek kushtëzimi dhe lëshimi i sovranitetit në shkëmbim të afrimit me BE-në. Është afërmendsh që një qeveri shqiptare që pranon kushtëzimet e BE-së dhe lëshon sovranitet në reforma themelore si ajo e drejtësisë, por nuk shpërblehet me integritim herët a vonë do i rezistojë kushtëzimit demokratik që vjen nga BE-ja.

Problemi është se për të njëjtën arsye antarësimi në BE është akoma më problematik për një vend si i yni që demokratizohet nga jashtë dhe jo nga brenda. Antarësimi në BE shënon fundin e procesit integruar dhe për pasojë edhe fundin e demokratizimit kushtëzues që vjen nga BE-ja. Dhe ky është një problem madhor për një vend si i yni ku përparimet e demokratizimit nga jashtë përballen me regresin e demokratizimit të brendshëm.

Institucionet që më shumë përparim kanë shënuar në demokracinë tonë janë procesi elektoral dhe sistemi i drejtësisë. Të dyja nën ndërhyrjen dhe presionin direkt të BE-së dhe faktorit ndërkombëtar në përgjithësi. Natyrisht ato janë shumë larg perfeksionit. Ama mjafton të krahasosh zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 me të gjitha proceset elektorale të viteve 90-të për të kuptuar se sa shumë janë përmirësuar proceset elektorale në Shqipëri. Po ashtu sistemi ynë i drejtësisë sot, pavarësisht problemeve të shumta, është shumë më i pavarur, profesional dhe i konsoliduar se drejtësia e viteve 90-të.

E kundërta ka ndodhur me institucionet tona të brendshme politike, jashtë presionit ndërkombëtar. Mjafton të shohësh partitë politike, parlamentin dhe mediat ku ndërhyrja ndërkombëtare ka qenë më e vogël ose inekzistente. Parlamenti i vitit 2022 është shumë më pak demokratik se ai i viteve 90-të. Po ashtu PS-ja dhe PD-ja e vitit 2022 janë shumë më pak demokratike se PD dhe PS-ja e viteve 1990. E njëjta gjë vlen edhe për mediat.

Natyrisht që as partitë, as parlamenti dhe as mediat e viteve 90 nuk ishin perfekte. Kishte intolerancë, autoritarizëm, mungesë profesionaliteti edhe deri në dhunë që përgjakte Kuvendin e Shqipërisë dhe Sheshin Skënderbej. Ama nëse në vitet 1990 kishte debat real si në parti, si në parlament edhe në media, sot këto institucione janë atrofizuar. Parlamenti është kthyer në vulë të ekzekutivit, partia në shtojcë të kryetarit dhe media në shtojcë të politikës dhe interesave ekonomike. Republika Parlamentare që kishim dje, edhe pse me probleme, sot është reduktuar në një Republikë Kryeministrore që e ka boshatisur demokracinë nga cdo përmbajtje reale.

Ndaj pyetja që duhet të shtrojmë sot nuk është se kur do të anëtarësohet Shqipëria në Bashkimin Evropian, por çfarë do të ndodhë me demokracinë e atrofizuar shqiptare pas këtij antarësimi që do i japë fund kushtëzimit demokratik nga jashtë. Nëse në vende si Bullgaria, Rumania, Polonia dhe Hungaria antarësimi ka prodhuar regres çfarë do të ndodhë me Shqipërinë? Çfarë duhet të bëjmë që ëndrra evropiane mos të kthehet në një makth diktatorial? Natyrisht përgjigjen ndaj kësaj pyetje e dimë, duhet demokratizim nga brenda. Problemi është se pas më shumë se tre dekadash demokratizimi nga jashtë kemi humbur aftësinë për t'u demokratizuar nga brenda. Ndaj vazhdojmë të flasim për integrimin evropian dhe BE-në edhe pse kjo e fundit tashmë vetëm flet me veten.

*Ky shkrim është pjesë e serise së shkrimeve rreth integritit evropian”, te Institutit Shqiptar te Medias, në kuadrin e Programit te Promovimit te Tranzicionit te Republikës Çeke.*